



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Procesverbal i mbajtur më 11 mars 2025, në mbledhjen e XXXIII-të (tridhjetetë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:10

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje sipas listës së nënshkrimeve të pranishëm ishin anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Sebastina Vokrrri; Bashkim Sylja; Mrika Thaçi). Bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje e pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA.

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke konstatuar kuorumin ku të pranishëm janë të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, në vazhdim theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse e hedh në votim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 28 janar 2025

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime, miratohet procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e datës 28 janar 2025

2. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Objektivit Çerdhe Publike në fshatin Balloc - Komuna e Podujevës

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pra kemi të bëjmë me këtë propozim vendim të cilin e ka sjellë Drejtoria e Arsimit dhe që ka paraparë që të ndërtohet një Çerdhe në fshatin Balloc. Për më shumë këtu prezent e kemi drejtorin e Drejtorisë së Arsimit i cili ka për të shtuar diçka edhe pse materialin e kësaj pike e keni marrë me kohë ku janë të gjitha informatat dhe dokumentet që nevojiten.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, e paraqiti fjalën hyrëse për këtë pikë të rendit të ditës, theksoi, para vetës keni një propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Objektivit Çerdhe Publike.

Meqë në vijë kadastrale është fshati Balloc, mirëpo bëhet fjalë për në oborrin e shkollës “Dëshmorët e Kombit” e cila njohët si shkollë e qytetit dhe kjo vije pas një kërkesë, dhe duke u bazuar në dokumentet e planifikimit të Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për ndërtimin e Çerdheve publike në Komunën e Podujevës ku dhe Drejtoria e Arsimit ka identifikuar këtë parcelë si nevojë nga komuniteti që është andej, kështu që para vetës keni këtë propozim i cili kërkohet të rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës që është caktuar të mbahet më 13 të këtij muaji.

z.Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim propozim vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Çerdhe Publike, pasi që konsiderojmë se është interes i përgjithshëm dhe është e domosdoshme kudo që ka mundësi, madje tani është edhe financim i Ministrisë së Arsimit, do të thotë është me buxhet të kësaj Ministrie andaj edhe konsiderojmë se është e dobishme për qytetarët e asaj ane.

z.Naim Çunaku, theksoi, edhe Grupi i LDK-së e mbështetë këtë propozim vendim për caktimin e lokacionit për Çerdhe. Ndoshta paksa po dal jashtë temës por e kem me drejtorin e DKA-së që ka qenë për keqardhje në mbledhjen e kaluar kur edhe ne si grupim politikë qoftë në KPF qoftë në Kuvend por edhe gjithherë kemi thënë se për çdo investim që bëhet në të mirën e qytetarëve dhe që lehtëson sado pak jetën e tyre kurrë LDK nuk është kundër dhe nuk ka qenë kundër, ndërsa nëpër portale ka dal që, për të mos thënë dezinformuat që LDK e ka lëshuar mbledhjen dhe nuk e ka përkrahë, andaj do të apeloja që të kihet kujdes me këto sepse mund të vazhdojmë me këso gjërash mirëpo vetëm rëndojmë raportet njerëzore, por nuk arrijmë asgjë tjetër.

E përmenda edhe në fillim, edhe Grupi i këshilltarëve të LDK-së e mbështetë caktimin e lokacionit për ndërtimin e Çerdhes edhe pse ne nuk e dim por që do të ishte mirë që tek investimet kapitale një prej procedurave të para që ka qenë dashtë të merret parasysh është konsultat gjegjësisht organizimi i debateve me qytetarë sepse më mirë se ata askush nuk e din, mirëpo si do qoftë pa paragjykuar se nuk janë konsultuar qytetarët, LDK në këtë rast Grupi i këshilltarëve të LDK-së e mbështetë caktimin e lokacionit për ndërtimin e Çerdhes dhe çdo investim tjetër çfarëdo qoftë në të mirën e qytetarëve.

z.Bashkim Sylja, theksoi, edhe e Grupi i PDK-së e mbështetim caktimin e lokacionit për ndërtimin e Çerdhes Publike në fshatin Balloc.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim që t’i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim në mbledhjen e radhës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

3. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave ka sjellë një propozim vendim sipas kërkesës së KRM “Pastrimi” që të mbështetet me mjete financiare, mirëpo për më gjerë këtu prezent e kemi drejtorin e kësaj Drejtorie i cili mund të na informon më shumë rreth kësaj pike.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse për këtë pikë të rendit të ditës, theksoi, dihet se Kompania “Pastrimi” është një Kompani rajonale e cila kryen funksionin e vet për pastrimin e qyteteve të rajonit të Prishtinës, andaj duke pas parasysh që kjo kompani është në një gjendje jo të mirë financiare për arsye të ndryshme ka bërë një kërkesë për mbështetje financiare nga ana e Komunës së Podujevës.

Gjatë vitit të kaluara është ndërtuar edhe një objekt për të cilin ka pasë një Marrëveshje të Mirëkuptimit në mes Komunës së Podujevës dhe KRM “Pastrimi” këtu në qytetin e Podujevës, dhe kjo për atë arsye paksa e ka vendos në vështirësi financiare Kompaninë “Pastrimi” ku Komuna e Podujevës nuk ka arritur të kryej të gjitha obligimet për arsye të mënyrës se qysh është zhvilluar kontrata nuk kemi arritur ta ekzekutojmë atë pagesë, kështu që kjo kërkesë tani e Kompanisë “Pastrimi” ka qenë për ta mbështetur financiarisht ku si kërkesë është për 99,500.00€ mirëpo duke pasë parasysh kufizimet buxhetore tonat si Komunë, kemi propozuar që kësaj Kompanie t’i ndahen 60,000.00€ dhe që 30,000.00€ të ekzekutohen në vitin 2025 dhe 30,000.00€ tjera të ekzekutohen në vitin 2026, e që edhe kjo ndarje bëhet për arsye të kufizimeve buxhetore të cilat i kemi.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e mbështesim këtë propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A.

z.Naim Çunaku, theksoi, edhe ne Grupi i LDK-së e mbështesim që kjo pikë e rendit të ditës të kaloj në Kuvend, mirëpo edhe këtu në KPF por edhe në mbledhjen e Kuvendit qëndrimi jonë është që po krijohet një pabarazi në mes operatorëve ekonomik, dhe kur herën e fundit në këtë Kuvend kur kemi vendos të japim një subvencion për Kompaninë “Pastrimi” si organizatë publike fitimprurëse dhe vetë financuese, nuk e di deri kur duhet që ne nga buxheti i Komunës të japim apo të derdhim mjete financiare në atë xhirollogari për arsye të menaxhimit të tyre që nuk janë në gjendje të ekzistojnë nga ato të hyra që i inkasojnë.

Drejtori parafolës e përmendi por që nuk e kuptova shumë sakt kur e tha që një kontratë që kemi pas me këtë Kompani, sa unë e kam parë aty ka qenë një akt Memorandum i Mirëkuptimit, por jo kontratë sepse përndryshe kontratën nuk do të kishte fare nevojë ta sillte në Komunë por do të shkonte përmes përmbaruesit dhe do ta ekzekutonte atë pagesë, mirëpo aty ka qenë një dakordancë gjegjësisht një akt i një Marrëveshjeje në mes të Komunës dhe KRM “Pastrimi” për ndërtimin e objektit të kësaj Kompanie, prandaj unë ju pyes juve por edhe pyes veten, përse duhet që një kompani fitimprurëse dhe vetë financuese të financohet nga buxheti i Komunës dhe me këtë a jemi duke treguar që jemi kundër ekonomisë së tregut sepse në Komunën tonë jemi në dijeni që operojnë dy kompani pastruese dhe a ka qenë dashtë që njëra kompani të financohet tash për tretën herë në këtë mandat, kurse kompania tjetër që është nën menaxhim privat asnjëherë, andaj në një formë po intervenojmë në një diçka që krijon pabarazi te operatorët ekonomik gjegjësisht në kundërshtim me logjikën e ekonomisë së tregut.

Edhe njëherë po e them se ne Grupi i LDK-së sot i japim vizë këtij propozim vendimi që të shkoj në Kuvend, mirëpo vërtetë të paguhen 60,000.00€ nga 95,000.00€ sa i ka kërkuar kompania në fjalë, në një formë e detyron qytetarin e Komunës së Podujevës që dy herë të paguaj për shërbimet që ajo kompani ofron, kur e them që dy herë paguajnë qytetarët e kam parasysh këtë që në rend të parë ajo kompani njëherë inkason në bazë të tarifës për pjesën që i takon, dhe herën e dytë përmes taksave të tyre përmes Kuvendit edhe njëherë. Kështu që mendoj që kësaj logjike ato organizata, kur kemi parasysh se ne kemi vetëm një organizatë komunale, dhe nëse ata nuk janë në gjendje për arsye menaxheriale të tyre, me

mbipunësim e mbipopullim të asaj Ndërmarrje dhe që nuk janë në nivel të detyrës për ta bërë një afarizëm të suksesshëm, deri kur ne si Kuvend dhe si Komunë t'ju japim para nga buxheti i Komunës, e them këtë sepse këto mjete financiare që i ndahen asaj Ndërmarrje ne sigurisht që duhet të shkurtojmë diçka nga projektionet që ka pasë Komuna andaj ne sot kategorisë së subvencioneve me ngritjen e dorës i'a shkurtojmë plotë 60,000.00€ për një financim të pabarabartë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim në mbledhjen e radhës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

4. Propozim Plan i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB, për vitin 2025

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, me leje të drejtorit të Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit z.Bahri Selimi i cili është edhe koordinator i KKSB-së por që për shkak të një obligimi nuk pati mundësi të jetë këtu prezent, propozojmë Planin e Punës së KKSB-së për vitin 2025 që të kaloj në Kuvend ku edhe pastaj të kemi një diskutim më të gjerë të këtij Planit.

z.Haki Rudari, theksoi, natyrisht se ne Grupi i LVV-së e përkrahim këtë Plan të punës së KKSB-së për vitin 2025, por përmes një Rregulloreje përshihet që KKSB ta njoftoj Kuvendin Komunal dy herë brenda vitit, prandaj unë propozoj që në këtë Plan të jetë një informatë e KKSB-së për Kuvendin e Komunës dhe atë në majin korrik si dhe informata tjetër për gjashtëmujor e dytë të jetë në muajin dhjetor.

Unë këtu në këtë Plan nuk kam parë që parashihet një informatë e tillë për gjashtëmujorin e parë të vitit, prandaj dëshiroj të propozoj që të jetë pjesë e Planit të Punës së KKSB-së për vitin 2025. Pra edhe njëherë po e citoj propozimin, Informatë e KKSB-së në Kuvendin e Komunës për gjashtëmujorin e parë, për arsye se me një Rregullore përshihet që të paktën dy herë brenda vitit KKSB të paraqet në Kuvendin e Komunës Informata të tilla.

z.Naim Çunaku, theksoi, vërtetë një prej obligimeve ligjore të punës së Komunës, gjegjësisht Ekzekutivit dhe Kuvendit, sigurisht për një mbarëvajtje të punës duhet t'i paraprijnë planet e punës e në vazhden e tyre edhe Plan i punës së KKSB-së i cili është i mirëseardhur. Ndërsa sa po i përmbahemi planeve të punës besoj se nuk kemi diskutim sepse planet po i bëjmë vetëm sa për letër, mirëpo si Plan i punës së KKSB-së ne Grupi i LDK-së do ta përkrahim.

Vërtetë do të doja që një Plan i tillë ta ketë edhe Ekzekutivi i Komunës, Kryetarit të Komunës, edhe Zyra e prokurimit e cila e ka obligim ligjor e që tani jemi në muajin mars dhe nuk e kemi planin e punës së Zyrës së prokurimit për vitin 2025 gjegjësisht synimet e tyre për realizmin e projektbuxhetit të Komunës i cili është miratuar në muajin shtator të vitit të kaluar. Andaj çdo plan të tillë të paktën nuk e kemi në Kuvend e që mendoj se ka qenë dashtë të jetë në veçanti planin e Zyrës së prokurimit gjegjësisht menaxhuesit të projekteve ta kemi një Plan mbi dinamikën e zhvillimit të projekteve në Komunën tonë.

Si i tillë, po kthehem në fillim, ne çdo Plan e përkrahim por edhe këtë Plan të punës së KKSB-së.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, dëshiroj të jap vetëm një sqarim të nderuarit asambleist që Planet e punës të të gjitha drejtorive janë në ueb site të Komunës, duke përfshirë edhe Planin e Prokurimit qoftë atë fillestar qoftë atë përfundimtar. Tani normal se ka ndryshuar ajo struktura e emërimit të drejtorëve të Drejtorive sepse drejtorët emërohen nga Kryetari i Komunës dhe ata i raportojnë Kryetarit, mirëpo planin e punës e kanë të bashkëngjitur në ueb site të Komunës.

z.Naim Çunaku, theksoi, pa dashur të kuptohet si polemikë me parafolësin por fundja si do qoftë merret kjo. Se si është e organizuar Komuna gjegjësisht organet e Komunës besoj që të gjithë ne këtu e dimë dhe që prej vitit 2007 kur kemi zgjedhje të drejtpërdrejt për Kryetar të Komunës e dimë që Kryetari i Komunës i zgjedhë drejtorët e Drejtorive që është një diçka tani më praktike në Kosovë.

Nga ajo që fare nuk e kundërshtoj që Planet e tilla mund të jenë në ueb site të Komunës, mirëpo kur kemi parasysh që hedhja në ueb site pa konsultim me Kuvendin e Komunës dhe pa i dhënë të drejtën Kuvendit të japë sugjerimet gjegjësisht ta pasuroj atë plan të punës, në një formë nuk kemi shkuar në atë masë që të komunikojmë edhe me Kuvendin e Komunës përmes ueb site-it të Komunës, por sigurisht që për ato Plane të punës në rend të parë ka dashtë të kemi mundësinë edhe anëtarët e Kuvendit që të japin fjalën e tyre apo sugjerimet e tyre. Dhe një praktikë gjithandej Kosovës ndoshta vlen edhe për ty zotëri kryesues i Kuvendit, e din që gjatë muajit të kaluar dhe në këtë muaj një pjesë e madhe e Kuvendeve Komunale në nivel të Kosovës ku që të gjitha pika të trajtimit i kanë pasë këto që i përmenda unë paraprakisht siç janë Planet e punës së Ekzekutivit të Komunës, Kryetarit të Komunës, Zyrës së prokurimit.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim në mbledhjen e radhës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, përfshirë edhe propozimet e paraqitura nga kolegu z.Haki Rudari që në Planin në fjalë të përfshihen edhe dy Informata të KKSB-së për Kuvendin e Komunës dhe atë për gjashtëmujorin e parë të vitit dhe gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim të këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes si dhe me rekomandim që në Planin përkatës të përfshihen edhe:

-Në muajin korrik 2025 të parashihet të sjellët në Kuvendin e Komunës - Informatë e Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi KKSB, për gjashtëmujorin e parë të vitit.

-Në muajin dhjetor 2025 të parashihet të sjellët në Kuvendin e Komunës - Informatë e Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi KKSB, për gjashtëmujorin e dytë të vitit.

5. Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, drejtoresha e kësaj Drejtorie e ka sjellë materialin përkatës që është kjo Informatë e cila ju është përcjellë me thirrjen e kësaj mbledhje por për momentin nuk ka pas mundësi të jetë sot prezentë në këtë mbledhje për ta prezantuar por sigurisht se do t prezantoj në mbledhjen e Kuvendit që do të mbahet pasnesër.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, ju njoftoj se për arsye objektive drejtoresha e DBPZHR nuk ka pas mundësi të jetë prezentë në këtë mbledhje, kështu që propozoj që kjo Informatë përkatëse e DBPZHR të rekomandohet për diskutim dhe shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit më 13.03.2025.

z.Naim Çunaku, theksoi, vërtetë edhe para kësaj seance kemi pas fjalë miradie për një prej drejtorive që më së shpeshti ka raportuar që ka qenë DBPZHR dhe në këtë drejtim në një formë jemi paska të kënaqur në kuptimin që e ka përfillë edhe Planin e punës së Kuvendit dhe ka përfillë edhe raportimin gjegjësisht anën se si duhet të zhvillohet Ekzekutivi që duhet të jetë llogaridhënës para Kuvendit por që sot drejtoresha sot nuk është këtu prezentë e që ndoshta mund të jetë një hendikep, arsyet nuk i di edhe pse ndoshta mund të jenë arsyet të një natyre që vërtetë i'a kanë pamundësuar të jetë prezentë dhe jemi në rregull dhe do të debatojmë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës pasnesër.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim në mbledhjen e radhës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 8 vota Për, 1 votë Kundër, dhe asnjë votë të Përmbajtur, i rekomandohet Kuvendit të Komunës për diskutim të kësaj Informate sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30

**Procesverbalin e mbajti;
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0014618/25
Podujevë,
11 mars 2025**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit
Hilmi Hoxha**